



**Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly**

Komisioni për Shërbime Publike,
Administratë Lokale dhe Media
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.
27.06.2008, ora: 13:00, N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Esat Brajshori, Fehmi Mujota, Shpresa Murati, Melihate Tërnkolli, Gani Buqinca, Hajdin Abazi, Anita Morina, Synavere Rysha, Radmila Vujovic, ndërsa munguan : Ali Lajçi dhe Rasim Selmanaj.
Nga zyra koordinuese e komisionit morën pjesë: Shpresa Ramosaj, Drita Morina, Fatime Qorri dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e udhëhoqi Esat Brajshori, kryetar i Komisionit, me këtë:

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime në Projektligjin për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. L – 062/1.
4. Të ndryshme.

Rend dite:

Pika e parë e rendit të ditës -
Procesverbali u miratua pa vërejtje

Pika e dytë e rendit të ditës -
Komisioni shqyrtoi dy amendamentet e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim:

Amendamenti 1

Neni 6, paragrafi 3 i Projektligjit, në tekstin në gjuhën shqipe, të harmonizohet me versionin në gjuhën serbe dhe angleze, duke fshirë fjalën “**komunale**”.

Amendamenti 2

Në nenin 8, paragrafin 3 (i) të Projektligjit, në tekstin në gjuhën serbe, fshihen fjalët **Republike Kosova** dhe zëvendësohen me fjalët “**Republika Kosovo**”.

Pas shqyrtimit të dy amendamenteve komisioni funksional për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, nuk i përkrahu amendamentet e propozuara nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në Projektligjin për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës .

Pika e tretë e rendit të ditës -

Esat Brajshori - Për këtë pikë të rendit propozoi formimin e grupit punues nga radhët e anëtarëve të komisionit për shqyrtimin e P/ligjit për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës. Për anëtarë të grupit punues komisioni propozoi:

- Fehmi Mujota
- Melihate Tërmkolli, dhe
- Shpresa Murati

Për këta kandidatë komisioni votoi unanimisht.

Pika e katërt e rendit të ditës -

Komisioni diskutoi rreth radhitjes së raportit vjetor të RTK-së në seancën plenare të 30.06.08 dhe qëndrimin e Komisionit për Buxhet për shtyrjen e raportit të RTK-së për ndonjë seancë tjetër me arsyetimin se Raporti i RTK-së nuk është shqyrtuar nga Komisioni për Buxhet konform ligjit për RTK-në .

Kryetari i Komisionit:

Esat Brajshori